



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1593 Prot.

Lezhë, më 02 . 02 . 2026

VENDIM

Nr. 5, Datë 28. 01. 2026

**Për një ndryshim në VKB nr.113, datë 15.12.2025 “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; dhe shkresës së Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr.764, datë 19.12.2025 “Shkresë përcjellëse mbi vendimin përfundimtar të KVA-së në kuadër të GBP 2025”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

**Vendosi:**

1.Miratimin e një ndryshimi në Buxhetin e Vitit 2026, konkretisht:

- a. Në pikën 1/a “Plani i të ardhurave” shtohen burimet në shumën 3,222,170.24 lekë, grant i bazuar në performancë për vitin 2025 me burim financimi nga financimi i huaj.
- b. Në pikën 1/b “Plani i shpenzimeve” shtohen shpenzimet në shumën 3,222,170.24 lekë, në Programin Buxhetor AB127 “Rendi dhe Siguria Publike”, në Funkcionin “10910”.

2.Miratimin e përdorimit të fondit me burim financimi të huaj për projektin: “Ndërtim pritash malore në dy degëzimet e Përroit të Bardhë dhe rehabilitim i urës në fshatin Zejmen, Nj.Administrative Zejmen” në shumën 3,222,170.24 lekë.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngakohen: Drejtoria e Emergjencave Civile, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, e ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI



Nr. 15531, Prot

Dt. 9-2-26



K.B

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 117/6 Prot.

Lezhë, më 09.02.2026

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr. 107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjin nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, në Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 5, datë 28.01.2026 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për një ndryshim në VKB-në nr. 113, datë 15.12.2025 "Për miratimin e PBA-se 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026".

PREFEKTI

Taulant MALSHI

